

**EMËRVENDET DHE NDARJA ADMINISTRATIVE E
VILAJETEVE SHQIPTARE**

(Tahir Sezen, *Ndarja administrative e vilajeteve shqiptare (emrat e vendeve dhe statusi i tyre)*, përgatiti dhe përktheu Hatixhe Ahmedi, botoi Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës, Prishtinë, 2021)

Dihet mirëfilli se trojet tona kanë një histori të gjatë dhe të pasur me toponime që shprehin autoktoninë dhe rrënjët tona të hershme në këto hapësira, por edhe aso të shtresuara nga ndikime të ndryshme të qytetërimeve të cilave u kemi takuar dhe për të cilat kemi kontribuar. Megjithatë, një pjesë e këtyre emërve ka ardhur deri në ditët e sotme, në trajta të tjera gjuhësore - kundruall shqipes, edhe si pasojë e sundimeve të huaja që kanë mbizotëruar në trevat tona përgjatë shekujve e moteve. Prandaj, të gjithë emrat gjeografikë në hapësirat tona dëshmojnë dhe janë të lidhur me historinë dhe të kaluarën tonë, e cila histori dhe e kaluar nuk mund të njihen dhe nuk mund të studiohen ndryshe pa i njohur, në rend të parë, emërvendet, etimologjinë e tyre, ndarjen administrative dhe statusin e tyre nëpër kohë.

Sikundër jemi të bindur përgjithësisht se bota do të shndërrohej në një kaos të vërtetë në qoftë se nuk do të ekzistonin emrat gjeografikë, po ashtu në një kaos të ngjashëm do të vërtitej edhe historia dhe e kaluara e një populli a një vendi po të mos njiheshin pikërisht emrat e tij historikë. Prandaj, studimi i emërve jo vetëm se është i rëndësishëm për të njohur të kaluarën, por ai është i nevojshëm dhe i domosdoshëm edhe për arsye praktike, ngaqë ai shërben si mjet komunikimi midis periudhave e etapave historike e brezave të ndryshëm, pra të kaluarës, të tashmës dhe të ardhmës.

Këtë synim pikërisht ka edhe libri *Ndarja administrative e vilajeteve shqiptare (emrat e vendeve dhe statusi i tyre)* i autorit dhe arkivistit shumëvjeçar në Arkivin e Stambollit, Tahir Sezenit (1934-2014), të cilin e ka përkthyer në gjuhën shqipe dhe e ka përgatitur, po ashtu, arkivistja, studiuesja dhe osmanologia në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, Hatixhe Ahmedi, kurse e ka botuar Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës, që studiuesve dhe të interesuarve të tjerë t'u ofrojë të dhëna dhe t'u dalë në ndihmë për njohjen e emërve, ndarjen administrative dhe statusin e tyre për një periudhë të rëndësishme të historisë sonë, pra për periudhën disashekullore osmane.

Ky libër merr vlerë dhe rëndësi edhe më shumë kur kemi parasysh edhe faktin se një numër i madh i këtyre emërvendeve për arsye dhe rrethana të ndryshme, shumica të qëllimshme e dashakeqe, të cilat tashmë dihen, në periudha të mëvonshme, kanë pësuar ndryshime dhe tjetërsime, transformime e devijime, e disa kanë ngelur të shënuara, aty-këtu, në ndonjë hartë të zhbravitur apo në ndonjë dokument të vjetër arkivor e disa të tjera, për më keq, edhe janë bërë si të huaja, madje edhe janë harruar.

Më shumë se kaq, vlera e këtij libri është ku e ku më e madhe, kur kemi parasysh edhe faktin tjetër se ai na jep një pasqyrë të mirë për vilajetet e dikurshme shqiptare (Vilajetin e Kosovës, të Shkodrës, të Manastirit dhe të Janinës) dhe për ndarjen administrative të tyre përgjatë periudhës osmane, vilajete këto të cilat përfshinin një hapësirë jashtëzakonisht të madhe krahasuar me atë që sot banohet dhe administrohet nga shqiptarët.

Nga të dhënat e paraqitura në këtë vepër rezulton se vilajetet shqiptare përgjatë qeverisjes osmane kanë pësuar ndryshime të vazhdueshme si për sa i përket shtrirjes gjeografike, po ashtu edhe njësisive dhe funksioneve të strukturave, varësisht nga rrethanat dhe interesat administrative, politike e strategjike të kësaj qeverie.

Njohja e mirë e ndarjes administrative dhe e statusit të vendbanimeve etnike shqiptare na bën të kuptojmë më mirë funksionimin e gjithëmbarsëm të jetës shoqërore, politike, ushtarake, ekonomike e kulturore-arsimore të viseve shqiptare në atë kohë, por edhe të funksionimit të institucioneve përkatëse dhe të rolit të tyre në jetën e shqiptarëve.

Libri *Ndarja administrative e vilajeteve shqiptare (emrat e vendeve dhe statusi i tyre)*, i cili është botuar në bazë të marrëveshjes midis dy institucioneve: Kryesisë së Arkivave Shtetërore të Turqisë dhe Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, në aspektin metodologjik hapet me fjalën e botimit të parë në gjuhën turke të shkruar nga drejtori i përgjithshëm i Arkivave Shtetërore të Republikës së Turqisë, z. Jusuf Sarinaj (Yusuf Sarinay) (f. 5), për t'u pasuar nga parathënia e botimit të dytë në gjuhën turke e shkruar nga kolegu dhe drejtori tjetër i këtij institucioni, dr. Ugur Ynal (Uğur Ünal) (f. 7-8), më pastaj vjen fjala e autorit Tahir Sezen (f. 9), fjala e botuesit në gjuhën shqipe nga kryeshefi i Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, mr. Bedri Zyberaj (f. 11-12) dhe nga fjala e përkthyeses dhe përgatitëses dr. Hatixhe Ahmedit (13-15).

Në vazhdim mbarështrohet pjesa kryesore, përkatësisht fjalori i emërvendeve sipas renditjes alfabetike (18-378). Emrat e vendeve janë dhënë në gjuhën turke, të transkriptuar edhe në tekstin arab ashtu siç hasen nëpër dokumente osmane, një ndihmesë e madhe kjo për studiuesit për identifikimin e këtyre emrave në gjuhën e dokumenteve në osmanishte.

Ndërsa studimi në botimet në gjuhën turke është dhënë në mënyrë tabelore, në botimin në gjuhën shqipe, pa i munguar asgjë nga përmbajtja, është paraparë, sipas nesh me të drejtë, që të jepet si tekst lineare, që e bënë më të lehtë përdorimin dhe shfrytëzimin e kësaj vepre.

Në fund të librit janë paraqitur *Indeksi i emrave të vendeve* (gjithsej 877 emërvende) (f. 379-412) së bashku me burimet dhe literaturën e shfrytëzuar (f. 413-415).

Ky libër paraqet, sikurse u tha, punën shkencore prej disa dekadash të arkivistit dhe studiuesit të Arkivit Osman në Republikën e Turqisë, z. Tahir Sezenit, i cili për hartimin e kësaj vepre ka shfrytëzuar numër të madh burimesh relevante, si defterë, regjistra, vjetarë (sallnâme) e dokumente të tjera arkivore osmane, duke na mundësuar që të kemi një tablo të përgjithshme jo vetëm për emrat e vendeve në kuadër të Perandorisë Osmane, pra edhe të vilajeteve shqiptare si pjesë e saj, por edhe për ndarjen administrative (nahijet, kazatë, sanxhaqet etj.) dhe statusin e këtyre vendeve ndër vite gjatë qeverisjes osmane.

Ç'është e vërteta, libri *Ndarja administrative e vilajeteve shqiptare (emrat e vendeve dhe statusi i tyre)* është pjesë e një vepre më të vëllimshme të autorit Tahir Sezen, me titull *Osmanli yer Adlari (Emrat e vendeve gjatë Perandorisë Osmane)*, vepër kjo e cila, për shkak të rëndësisë dhe të interesimit të madh të studiuesit, ka njohur dy botime në Republikën e Turqisë (botimi i parë në vitin 2006 dhe botimi i dytë i plotësuar në vitin 2017), por të cilën vepër studiuesja Hatixhe Ahmedi e ka parë të arsyeshme që të na e sjellë në gjuhën shqipe, sikurse e thotë ajo vetë në fjalën e saj, në një version më të shkurtuar, me një titull pak më ndryshe dhe vetëm me emrat e vendeve të cilat bënin pjesë në hapësirat e dikurshme të katër vilajeteve shqiptare dhe atyre përreth.

Ky seleksionim nga ana e Hatixhe Ahmedit, pavarësisht prej dëshirës sonë për të kundërtën, na duket i kuptueshëm dhe i japim të drejtë për dy arsye.

E para, sepse vetë natyra e punimit mbi emrat e vendeve në Perandorinë Osmane përfshin një hapësirë të madhe si për nga gjerësia dhe thellësia e materialit, ashtu edhe për nga shtrirja kohore dhe hapësinore e tij, prandaj dhe ka kërkuar një vëllim më të madh, aq sa në botimin e saj në origjinalin në turqisht tejkalon 1 150 faqe, të cilave kur t'ia shtojmë edhe shënimet plotësuese të bëra nga Hatixhe Ahmedi, numri i tyre do të shtohet edhe më shumë dhe vështirë se do të mund të përmblihdeshin në një vëllim të vetëm.

E dyta, Hatixhe Ahmedi, na thotë mendja, sikur ka pasur një dozë rezerve se në kuadër të gjithë këtij vëllimi të materies me vështirësi do të dilnin shumë në pah emrat e vendeve shqiptare dhe aq më pak, - dhe kjo si duket ka qenë frika e saj kryesore, - do të mund të kuptohej sa duhet

shtrirja gjeografike aq e madhe e trojeve shqiptare në kuadër të Perandorisë Osmane, troje këto të cilat më vonë, me vendimet e Kongresit të Berlinit (1878), të Konferencës së Ambasadorëve në Londër (1912-1913) dhe të Konferencës së Paqes në Paris (1919), duke u bërë të vetmet troje në botë që kufizohen me vetveten, përkatësisht që kanë për fqinjë vetveten. Mirëpo, pavarësisht kësaj, ne shpresojmë se dr. H. Ahmedi, në një të ardhme të afërt do të na e sjellë në tërësi veprën e Tahir Sezenit, e për këtë ndërmarrje jemi të bindur se do ta ketë edhe përkrahjen e botuesit, Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, me çfarë do të shënohej edhe një kontribut i mirë shkencor përtej kontekstit shqiptar.

Sikurse vepra e plotë *Osmanli yer Adlari (Emrat e vendeve gjatë Perandorisë Osmane)* e Tahir Sezenit, që është shkruar me shumë mund e sakrificë, por me shumë dashuri e pasion, po me aq përkushtim e përgjegjësi është përkthyer, përgatitur dhe është plotësuar me të dhëna shtesë edhe versionin e shkurtuar i saj nga ana e Hatixhe Ahmedit, e cila duke qenë edhe vetë me vokacion studiuese dhe me përgatitje profesionale arkiviste dhe osmanologe, sikurse edhe autori Tahir Sezeni, me shpjegimet dhe me plotësimet e shumta, të qëlluara e të nevojshme që i ka bërë në poshtëshënime, të mbështetura kryesisht në burime enciklopedike, - sidomos për ato vende, të cilat, fatkeqësisht, sot kanë mbetur jashtë administrimit tonë dhe nuk banohen nga shqiptarët, - na lejojnë të themi se në kuadër të këtij botimi pothuajse i gjejmë të përfshira dy vepra në një.

E kur jemi këtu, nuk mund të mos e përmendim edhe një gjë e cila lidhet me motivet që e kanë shtyrë Hatixhe Ahmedin për ta përkthyer e përgatitur këtë veprë. Përtej interesit shkencor dhe rëndësisë së kësaj vepre për njohjen e shtrirjes gjeografike, të emrave të vendeve dhe ndarjen administrative të trojeve shqiptare në kuadër të Perandorisë Osmane, motivi dhe qëllimi tjetër kryesor i saj ka qenë dhe është, sikurse e thekson edhe vetë ajo, që përmes kësaj vepre t'u dalë në ndihmë sidomos studiuesve të rinj, të cilët, - mbështetur edhe në përvojën e saj si punonjëse e re në Arkivin e Kosovës më 2009, - në fillimet e rrugëtimit të tyre shkencor, do të hasin në vështirësi të mëdha për njohjen e emërvendeve të trojeve tona dhe jo vetëm.

Në përmbyllje të këtij prezantimi, themi me bindje se libri *Ndarja administrative e vilajeteve shqiptare (emrat e vendeve dhe statusi i tyre)* i autorit Tahir Sezen, i përkthyer dhe i përgatitur në gjuhën shqipe nga dr. Hatixhe Ahmedi, do t'u lehtësojë punën studiuesve dhe hulumtuesve të ndryshëm, sidomos historianëve, gjeografëve, gjuhëtarëve, orientalistëve, arkivistëve etj.

Një projekt i natyrës së fjalorit për ndarjen administrative të vilajeteve shqiptare dhe për emrat e vendeve dhe statusin e tyre gjatë periudhës osmane nuk është ndërmarrë më herët te ne, prandaj dhe këtë libër e

vlerësojmë si të parin e këtij lloji që përmbledh një fond të madh të të dhënash të larmishme mbi realitetet gjeografike, historike etj. të trojeve shqiptare dhe atyre përreth gjatë periudhës osmane.

Përgjithësisht, është fjala për një libër me rëndësi shumëdimensionale e ndërdisiplinore për njohjen dhe studimin e të kaluarës dhe të kulturës së shqiptarëve, është një kartë identiteti për një fazë jo sa duhet të njohur historikisht e jo sa duhet të qartësuar shkencërisht. Ndaj, themi me gojën plot se studiuesit e të kaluarës dhe të kulturës shqiptare do të gjejnë te kjo vepër një burim të rrallë dokumentar për ta dëshmuar autoktoninë dhe vijimësinë e hapësirave etnike shqiptare.

Sadik Mehmeti
Fikrije Berisha

SHTOJCË I

